



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2 shkronja d), nenet 14.1 dhe 17 shkronjat a), q) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 15 parag. 1, 2.4, nenet 17.1 dhe 19 parag. 1.1 dhe 1.17, të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, si dhe në pajtim me Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal (SZHEL) 2016-2018 (pika 1.4, nënpika 1.17) e miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës 01-006-36586 të datës 29 prill 2016, Kuvendi I Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 02 nëntor 2018, miratoi këtë,

VENDIM

PËR RIDESTINIMIN E OBJEKTIT “PUSHIMORJA PËR NXËNËS DHE FËMIJË” TË MBETUR BONJAK NGA LUFTA E FUNDIT NË KOSOVË

Neni 1

Miratohet vendimi që objekti, “Pushimorja për nxënës dhe Fëmijë” të mbetur bonjak nga lufta e fundit në Kosovë, të ridestinohet objekt afarist (hotelier, shëndetësorë).

Neni 2

Arsyeja e ridestinimit të objektit të cekur është për shkak të arritjes së moshës madhore të atyre për çka objekti ka qenë i ndërtuar dhe destinuar si dhe për nevoja të zhvillimit ekonomik dhe turizmit në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal.

Neni 3

“Pushimorja për nxënës dhe fëmijë bonjak” në Orllan është e ndërtuar në njësitë kadastrale parcela P-1339-0 pjesë dhe P-1341-2 pjesë, pronë e Komunës, Zona Kadastrale Orllan.

Neni 4

Për zbatimin e vendimit për ridestinimin e objektit të “Pushimores për nxënës dhe fëmijë bonjak” në objekt afarist (hotelier, shëndetësorë) është Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-354/02-0087371/18

Podujevë,
02 nëntor 2018



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi